



PERLA


REVISTË SHKENCORE - KULTURORE 2009/2

TRAJTON

- LIDHJET KULTURORE SHQIPTARO – IRANIANE
- ALBANOLOGJI
- IRANOLGGJI
- PASQYRA E LIBRAVE
- KRONIKA KULTURORE

"SHENJA TË ZOTIT NË DRURIN E ULLIRIT"
MUHAMED TREPÇI, TIRANË, 2008.

Në novelën "Emblema e dikurshme", një prej veprave të kaluara pa ndonjë vëmendje nga shtypi letrar, shkrimtari I. Kadare mbështetet mbi një besëtytni popullore për të ç'kodifikuar historinë e një krimi, historinë e zhdukjes së një embleme, e cila përcjell brez pas brezi një kumt të kriptuar. Është fjala për "kujtesën e drurit". Pikërisht kur investigimi duket se ka hyrë në një rrugë të pashpresë, një prej plakave më të moshuara arrin të këshillojë rrugën që të shpie tek e fshehta: nata e krimit ka qenë me shi dhe vetëtima, ata që shkulën shenjën e emblemes së kryezotit kaluan para asaj peme, prandaj zbulimi i tyre ishte shumë i thjeshtë: njafton që të pritej ajo pemë dhe në zemrën e saj do të gjendeshin portretet e njerëzve të krimit. Nëna e moçme sigurisht nuk as që kishte ndonjë ide për efektin e blicit (vetëtimës) dhe celuloidit (drurit të pemës).



Madje as studiuesi nuk mund ta thotë nëse këshilla e saj kishte të bënte me këtë ngjashmëri. Por thelbi i asaj që këshillon nëna e moçme është se druri ka kujtesë.


Pikërisht kjo më erdhi ndërmend duke lexuar librin “Shenja të zotit në drurin e ullirit”, të autorit Muhamed Trepçi, përgatitur shqip e anglisht dhe botuar me shoqërimin e disa dhjetëra ilustrimeve nga më të habitshmet që vetë autori ka gjetur në “kujtesën e drurit”. Dhe jo në çfarëdo druri, por në atë të ullirit, një dru i shenjtë në të gjithë librat e shenjtë, në Bibël e në Kuran; por gjithashtu një dru i shenjtë edhe në besëtytnitë popullore pagane, në mitologji e madje dhe në praktikat e besimet moderne.


Libri është nxitur nga imazhet rastësore që autori i tij z. Trepçi i ka gjetur në prerje gjatësore të drurit të ullirit në përvojën e vet. Janë imazhe që përmbajnë imazhe floreale, të botës së gjallë dhe të vetë njeriut. Ato duket sikur janë bërë me dorë mjeshtri, por dora e mjeshtrit nuk ka pasur një fuqi të tillë që të hyjë në brendësi të “drurit të shenjtë”. Janë imazhe që kanë kuptim, por asnjë arsye ose talent njerëzor nuk i ka krijuar ato. Atëherë autori thotë me të drejtë se këto janë si shenja hyjnore.

Imazhet e librit janë paraqitur në formën e një ekspozite në një mjedis e para një publiku ndërkombëtar në Itali, në Muzeumin Nacional të Romës, në “Il Vittoriano”, ku janë certifikuar me të drejtën e paraqitjes edhe më tej si “vepra arti”,

Këto pamje janë cilësuar unikal dhe të papërsëritshme. “Mund të gjerden dhe më të bukura, por jo më si këto”, thotë autori. Ai, pavarësisht se nuk i referohet librit të Kadaresë dhe as krahasimit blitz-vetëtimë e celuloid-pemë, paraqet hipotezën se “pema ka aftësi të fotografojë” në prani të dritës së fortë. Cilësimi

“vepër arti” u është bërë këtyre imazheve joracionale duke u mbështetur në konceptet bashkëkohore të njërës prej esteteve dhe semiologëve më të njohur të kohës sonë Umberto Eco, i cili pyet: “Cili është dallimi





ndërmjet të krijuarit e një vepre artistike dhe të zbuluarit të diçkaje që duket se mund të jetë një vepër arti? Përgjigja mund të jepet pasi të analizohet interpretimi i një forme për të cilën ka shkruar Luigji Paryson". Gjithashtu autori u është referuar edhe pikëpamjeve estetike të piktorit të mirënjohur Picasos, i cili i është përmbajtur konceptit të estetizmit të "vlerave të një gjetje".

Autori flet në këtë libër edhe për ndjesitë e provuara gjatë përvojës së tij për identifikimin e këtyre imazheve dhe diskuton me të drejtë se kush duhet të konsiderohet "autor" i tyre, duke qenë kompetenca njerëzore e përjashtuar, që do të thotë se mbetet që të jenë krijesa estetike hyjnore, të natyrës ose të mbinatyrës. Studiuesi Trepçi mbështetet edhe në shpjegimet e fiziologut Walter Larcher: në libër flitet për ato që mund të quhen "stresë të pemës", ose për "emocionet që kalon pema e ullirit në jetën e vet shumë të gjatë, që mund të jenë shprehur si frymë në imazhet që libri përmban, krahas tekstit analitik.

Në këtë libër bëhet një përpjekje për ta nxjerrë koleksionin e imazheve të raportuara në drurin e prerë të ullirit nga një lidhje rastësore. Natyra ka krijuar vetë kryevepra madhështore, të bukura të frikshme, si Niagara. Por këtu nuk është fjala për një bukuri të tillë, imazhet janë me shpirt njerëzor. Pikërisht karakteri humanoid i këtyre imazheve, ose motivet e botës së gjallë (zogj, gjarpërinj, lule), e bëjnë autorin të mendojë se këto janë kumte që kanë një logjikë që mund të tejkalojë arsyen njerëzore dhe që ndoshta tejkalon edhe kompetencën e fuqisë së të natyrshmes. Megjithëse pa pretendimin për t'u bërë pjesë e një biblioteke shkencore- profesionale, autori e sheh objektin e vet si semiolog, si antropolog, si estet, si filozof e si teolog.

Duke qenë një argument pothuajse i panjohur jo vetëm në dijet shqiptare, por edhe në traditën e monumenteve natyrore të artit, autorit i është dashur të këshillojë mendimin përgjegjës të disa autoriteteve të shkallës parësore ndërkombëtare. Umberto Eco e ka orientuar autorin për të gjetur kuptimin e fshehtë për pothuajse të gjitha gjetjet ,që nga e zgjedhura prej tij për ekspozim dhe pastaj edhe për t'i botuar si një libër të ilustruar, sidomos me shpjegimet terminologjike për dallimin e një vepre arti njerëzore dhe të një vepre arti si gjetje, si gjendje, si dukuri e natyrës, pavarësisht se duket sikur natyra ka punuar dhe po punon me mendje dhe arsye, me talent dhe me dorë njerëzore. Një ndihmë shumë inkurajuese ka qenë për autorin guximi i dy studiuesve muzeologë dhe të veprave të artit të Museo Nazionale di Roma, profesorët Giancarlo Alu dhe Lucia Bonacini, që e vlerësuan si pasuri estetike koleksionin e tij dhe pastaj mundësuan ekspozimin. Ishte pikërisht ekspozimi që inkurajoi botimin. Poeti dhe studiuesi i artit, Gjergj Morena, lehtësoi komunikimin e autorit me mjediset kulturore italiane për realizimin e qëllimit të tij krijues. Ndërsa z. Zef Paci, profesor i historisë së artit në Akademinë e Arteve Tiranë dhe në Universitetin e Shkodrës, ishte i pari që vlerësoi se këto imazhe përbënin një koleksion të një fuqie krijuese, të një faktori ende të panjohur nga mendja njerëzore por as nga ana teknologjike dhe as nga ana cerebrale.

Studimi shoqërohet me sentenca të mendimtarëve të shquar të fushave të ndryshme të dijes: estetë, simbologë, semiologë, antropologë, filozofë, mitologë, antropologë, poetë, studiues të disiplinave të ngushta dhe sigurisht me përshkrime të detajuara të vetë autorit, për karakterin e figurave, për ngjashmëritë me imazhe të botës humane, për vlerat estetike të tyre etj.

Monika STAJA